



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 1 dhjetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e  
Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin**

---

**Zyrës së Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

I. HISTORIKU PROCEDURAL .....	3
II. PARASHTRIMET .....	5
III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE .....	11
IV. DISKUTIM.....	12
A. Aspekte paraprake .....	12
1. Paanshmëria .....	12
2. Koha e kufizuar dhënë të akuzuarve për t’u përgjigjur.....	13
3. Kërkesa urgjente e Mbrojtjes së Selimit për vizitë familjare.....	13
4. Masat në lidhje me z. Krasniqi.....	14
5. Qëllimi i masave .....	14
B. Konteksti i vendimit.....	15
C. Pretendimet për shkelje dhe rreziqet e paraqitura .....	16
1. Ndërhyrja ndaj dëshmitarëve të ZPS-së.....	16
2. Nxjerrja e informacionit të mbrojtur dhe konfidencial nga tre të akuzuarit 17	
3. Udhëzimet e lëshuara nga z. Thaçi .....	18
4. Lloji individual dhe kolektiv i sjelljes bazë .....	19
5. Përfundim .....	19
D. Veçimi i tre të akuzuarve nga të paraburgosurit e tjerë .....	20
E. Kufizimet e vizitave dhe komunikimeve me telefon për tre të akuzuarit .....	21
1. Kufizimet specifike lidhur me komunikime dhe vizitorë të përbashkët.....	22
2. Vizitat personale jo të privileguara .....	23
3. Kushtet gjatë vizitave .....	24
4. Vizitat konsullore.....	25
5. Mbikëqyrja aktive .....	26
6. Regjistri i vizitave personale jo të privileguara .....	27
7. Vizitat e anëtarëve të ekipit të Mbrojtjes të cilët nuk janë mbrojtës ose bashkëmbrojtës.....	27

8.	Vizitat dhe komunikimet me videolidhje dhe me telefon .....	28
9.	Regjistri dhe incizimet e vizitave dhe komunikimeve me video dhe audio 31	
F.	Letërkëmbimi .....	32
G.	Detyrimet e raportimit të Zyrës Administrative .....	33
H.	Të drejtat në fuqi që mbeten të pandryshuara .....	34
I.	Masa të tjera .....	35
V.	KLASIFIKIMI.....	36
VI.	VENDIM .....	36

**TRUPI GJYKUES II** I Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykses”), në bazë të neneve 3(2), 15, 23(1) dhe 40(6)(d) dhe (f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(b), 56(6), 57(2), 80(1) dhe 116(4)(d) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), rregullave të paraburgimit 1(3), 16(4), dhe 43(3) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative: Rregullorja e Paraburgimit (“Udhëzuesi i Punës për Rregulloren e Paraburgimit”),<sup>1</sup> neneve 1(3), 12(1), 13, 14, 15(1), 16(4), 17(3), 19(5) dhe (6) dhe 20(2) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet (“Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet”)<sup>2</sup> dhe neneve 14-18 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve (“Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve”).<sup>3</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural lidhur me arrestimin dhe paraburgimin e Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), dhe Rexhep Selimit (“z. Selimi”) (bashkërisht “tre të akuzuarit”), është shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BD-08-Rev1, Administratorja, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative: Rregullorja e Paraburgimit, 23 shtator 2020.

<sup>2</sup> KSC-BD-09-Rev1, Administratorja, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet, 23 shtator 2020.

<sup>3</sup> KSC-BD-10-Rev1, Administratorja, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, 23 shtator 2020.

<sup>4</sup> *Shih p.sh.* F00994, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 18-21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 tetor 2022, F00994/RED; F00802, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 13 maj 2022, konfidencial, para. 1-12. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 24 maj 2022, F00802/RED; F00819, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt*

2. Më 17 nëntor 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë urgjente për modifikimin e kushteve të paraburgimit (“Kërkesa”) për tre të akuzuarit,<sup>5</sup> që i kërkonte Trupit Gjykses të urdhëronte masat e përcaktuara në paragrafin 2 të Kërkesës, të cilat përfshinin kërkesën për veçimin dhe pezullimin e menjëhershëm të të gjitha komunikimeve për tre të akuzuarit përkohësisht.<sup>6</sup>
3. Më 17 nëntor 2023, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e përkohshëm mbi Kërkesën e ZPS-së (“Vendimi i Përkohshëm”)<sup>7</sup> me të cilin vendosi kufizimet e përkohshme të kontakteve me tre të akuzuarit.<sup>8</sup> Në të njëjtin Vendim, Trupi Gjykses urdhëroi Zyrën Administrative të dorëzonte parashtrime në lidhje me themelësinë e Kërkesës së ZPS-së, deri të martën në mesditë, 21 nëntor 2023 dhe Mbrojtjen t’u përgjigjej Kërkesës së ZPS-së dhe parashtrimeve të Zyrës Administrative, deri në orën 4 të mërkurën, 22 nëntor 2023.<sup>9</sup>
4. Më 18 nëntor 2023, Zyra Administrative dorëzoi raportin lidhur me zbatimin e Vendimit të Përkohshëm, në të cilin shpjegoi qëndrimin e vet për secilën prej masave të kërkuara nga ZPS-ja.<sup>10</sup>
5. Më 20 nëntor 2023, tre të akuzuarit dorëzuan një kërkesë urgjente për riklasifikimin e kërkesës së ZPS-së për audioincizim të fshehtë të vizitave jo të privileguara të tre të akuzuarve dhe autorizimin gjyqësor për incizime të tilla të

---

të *Paraburgimit të Kadri Veselit*, 26 maj 2022, konfidencial, para. 1-13. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2022, F00819/RED.

<sup>5</sup> F01933, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 17 nëntor 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 nëntor 2023, F01933/RED.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 2, 53.

<sup>7</sup> F01936, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 17 nëntor 2023, konfidencial. Ky vendim i riklasifikua si “publik” më 23 nëntor 2023.

<sup>8</sup> Vendimi i Përkohshëm, para. 5, 11(b).

<sup>9</sup> Vendimi i Përkohshëm, para. 11(d).

<sup>10</sup> F01937, Zyra Administrative, *Raport lidhur me Zbatimin e Vendimit të Trupit Gjykses II*, 18 nëntor 2023, konfidencial.

fshehta, të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.<sup>11</sup> Kërkesa u protokollua gabimisht në dosjen e çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve*. Ajo u tërhoq më pas<sup>12</sup> dhe u riprotokollua në dosjen e duhur gjyqësore.

6. Më 21 nëntor 2023, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet lidhur me Kërkesën e ZPS-së (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”).<sup>13</sup>

7. Më 22 nëntor 2023, Mbrojtja e tre të akuzuarve dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit dorëzuan përgjigjet ndaj Kërkesës së ZPS-së (përkatësisht, “Përgjigjja e Thaçit”,<sup>14</sup> “Përgjigjja e Selimit”,<sup>15</sup> “Përgjigjja e Veselit”,<sup>16</sup> dhe “Përgjigjja e Krasniqit”,<sup>17</sup>).

8. Më 23 nëntor 2023, ZPS-ja dorëzoi një sqarim në lidhje me Kërkesën e saj.<sup>18</sup>

## II. PARASHTRIMET

9. ZPS-ja parashtron se tre të akuzuarit kanë shkelur urdhrat e Trupit Gjykses duke zbuluar identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose duke ua shpërndarë përmbajtjen konfidenciale të dëshmimeve personave që i kanë vizituar në objektin e

---

<sup>11</sup> F01941, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Selimit, Thaçit dhe Veselit për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 20 nëntor 2023, konfidencial.

<sup>12</sup> F01972, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mbrojtjes për Tërheqje të Parashtrimit F01941*, 30 nëntor 2023, konfidencial.

<sup>13</sup> F01943, Zyra Administrative, *Parashtrime të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 21 nëntor 2023, konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më të njëjtën ditë., F01943/COR.

<sup>14</sup> F01944, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Kërkesës Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 22 nëntor 2023, konfidenciale.

<sup>15</sup> F01946, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Kërkesës Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 22 nëntor 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 nëntor 2023, F01946/RED.

<sup>16</sup> F01947, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Kërkesës Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 22 nëntor 2023, konfidenciale. Përgjigjja e Veselit u parashtrua në orën 17:42 dhe u dorëzua të nesërmen, më 23 nëntor 2023. Versioni i redaktuar u dorëzua më 24 nëntor 2023, F01947/RED. Versioni i redaktuar më tej publik u dorëzua më 28 nëntor 2023, F01947/RED2.

<sup>17</sup> F01945, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Kërkesës Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 22 nëntor 2023, konfidenciale.

<sup>18</sup> F01948, Prokurorja e Specializuar, *Sqarim i Prokurorisë në lidhje me Parashtrimin F01933*, 23 nëntor 2023, konfidencial.

paraburgimit. ZPS-ja parashtron gjithashtu se hetimet e saj kanë zbuluar tentime të mëtejshme për të penguar procesin gjyqësor, përfshirë dhënien e udhëzimeve se si duhet të japin dëshmi dëshmitarët dhe plane për kontaktimin e dëshmitarëve.<sup>19</sup>

10. ZPS-ja kërkon nga Trupi Gjyqësor që modifikimet e kushteve të paraburgimit për tre të akuzuarit të përfshijnë: (i) veçim të tre të akuzuarve nga të paraburgosurit e tjerë të cilët mbahen në objektin e paraburgimit;<sup>20</sup> (ii) refuzim të të gjitha vizitave personale jo të privileguara;<sup>21</sup> (iii) kufizim të atyre që mund të kenë komunikime personale jo të privileguara me tre të akuzuarit;<sup>22</sup> (iv) mbikëqyrje aktive, incizim dhe/ose kopjim, rishikim, dhe ruajtje të të gjitha vizitave jo të privileguara, komunikimeve, letërkëmbimit dhe materialeve të sjella dhe të nxjerra nga objekti i paraburgimit;<sup>23</sup> (v) kufizim të mëtejshëm të llojit të temave që mund të diskutohen gjatë komunikimeve jo të privileguara;<sup>24</sup> (vi) moslejim të vizitorëve të përbashkët për tre të akuzuarit dhe të paraburgosur të tjerë;<sup>25</sup> dhe (vii) vizita të privileguara për tre akuzuarit vetëm për takime me mbrojtësit dhe bashkëmbrojtësit e tyre përkatës.<sup>26</sup>

11. ZPS-ja kërkon që Zyra Administrative të informojë Trupin Gjyqësor për çdo dyshim për shkelje të këtyre urdhrave.<sup>27</sup> ZPS-ja kërkon gjithashtu që Trupi Gjyqësor të urdhërojë Zyrën Administrative të përpilojë raporte mujore për Trupin Gjyqësor dhe palët dhe në to të përfshijë: (i) regjistër të vizitave dhe thirrjeve telefonike (si të privileguara ashtu edhe jo të privileguara) për të katër të

---

<sup>19</sup> Kërkesa, para. 1, 6-35.

<sup>20</sup> Kërkesa, para. 2(h).

<sup>21</sup> Kërkesa, para. 2(d).

<sup>22</sup> Kërkesa, para. 2(b).

<sup>23</sup> Kërkesa, para. 2(c).

<sup>24</sup> Kërkesa, para. 2(g).

<sup>25</sup> Kërkesa, para. 2(f).

<sup>26</sup> Kërkesa, para. 2(e).

<sup>27</sup> Kërkesa, para. 2(i), 50.

akuzuarit në këtë çështje gjyqësore, së bashku me datën, orën dhe pjesëmarrësit; (ii) nëse janë mbikëqyrur dhe/ose incizuar aktivisht këto komunikime; (iii) kopje të të gjitha materialeve/letërkëmbimit të shkëmbyera (të dërguara ose të marra), përfshirë nëse janë sjellë apo nxjerrë, së bashku me identitetin e dërguesit dhe marrësit, llojin e dokumentit, dhe nëse është ruajtur një kopje; (iv) nëse Zyra Administrative ka vërejtur parregullsi; dhe (v) nëse Zyra Administrative ka hasur në vështirësi gjatë zbatimit të urdhrit të Trupit Gjyqësor.<sup>28</sup>

12. ZPS-ja pretendon se masat e kërkuara janë masat më pak kufizuese të mundshme që kërkohen për arritjen e objektivit në parandalimin e përsëritjes së aktiviteteve të palejueshme të tre të akuzuarve.<sup>29</sup>

13. Parashtrimet e Zyrës Administrative trajtojnë: (i) realizueshmërinë e masave të kërkuara nga ZPS-ja; (ii) burimet dhe kohën që nevojitet për zbatimin e këtyre masave, nëse urdhërohen; (iii) çdo masë shtesë ose alternative që gjykohet e disponueshme, në varësi të vendimit të Trupit Gjyqësor, për trajtimin e rreziqeve të identifikuar nga ZPS-ja; dhe (iv) probleme të tjera që i gjykon të përshtatshme për t'i ngritur në lidhje me Kërkesën.<sup>30</sup> Zyra Administrative bën të ditur se kushtet e propozuara nga ZPS-ja janë përgjithësisht të realizueshme. Megjithatë, Zyra Administrative thekson se mbikëqyrja aktive e vizitave personale dhe nëpërmjet videolidhjes dhe thirrjeve telefonike kërkon burime shtesë, gjë që kërkon disa kufizime të numrit të këtyre privilegjeve.<sup>31</sup>

14. Mbrojtja e Thaçit parashtron se atyre nuk u është dhënë koha ose materiali i nevojshëm për përgjigje të plotë ndaj thelbit të pretendimeve të ZPS-së.<sup>32</sup> Bazuar në përmbajtjen e parashtrimit të ZPS-së, Mbrojtja e Thaçit vë në dyshim nëse ZPS-ja ka

---

<sup>28</sup> Kërkesa, para. 2(i), 50.

<sup>29</sup> Kërkesa, para. 3.

<sup>30</sup> *Shih përgjithësisht* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 8-54.

<sup>31</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 39, 40, 43.

<sup>32</sup> Përgjigjja e Thaçit, para. 1.



vepruar me kujdesin e duhur sa i përket mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve dhe garantimit të integritetit të procesit gjyqësor.<sup>33</sup> Mbrojtja e Thaçit parashtron se kërkesa e ZPS-së përmban material që është hamendësues dhe i mjegullt, dhe pjesa më e madhe e transkripteve të paraqitura nuk lidhen me Kërkesën e ZPS-së.<sup>34</sup> Mbrojtja e Thaçit parashtron se ajo u dëmtua nga parashtrimi i ZPS-së, sepse paraqitja e këtij informacioni Trupit Gjykses, me gjasë ka komprometuar aftësinë e Trupit Gjykses për të qenë i paanshëm, ose që së paku ka krijuar një perceptim të arsyeshëm se Trupi Gjykses nuk mund të jetë më i paanshëm ose objektiv për vlerësimin e themelësisë së çështjes<sup>35</sup>

15. Mbrojtja e Thaçit parashtron më tej se masat dhe modifikimet e kërkuara nga ZPS-ja janë shproporcionale, nuk arrijnë të arsyetojnë synimin legjitim dhe nuk kanë bazë ligjore.<sup>36</sup> Konkretisht, Mbrojtja e Thaçit kërkon që Trupi Gjykses të hedhë poshtë kërkesën e ZPS-së për: (i) ndalimin e vizitave personale familjare; (ii) lejimin e vizitave të privileguara vetëm me mbrojtës dhe bashkëmbrojtës dhe autorizim paraprak për anëtarë të tjerë të ekipit; (iii) kufizimet e vizitave konsullore; (iv) vendosjen e mbikëqyrjes aktive dhe ruajtjen e incizimeve të komunikimeve jo të privileguara deri në përfundim të gjykimit; dhe (v) ndalimin e komunikimit jo të privileguar lidhur me informacionin publik për procesin gjyqësor.<sup>37</sup>

16. Mbrojtja e Selimit parashtron se masat e kërkuara nga ZPS-ja nuk mbështeten mjaftueshëm nga provat dhe nuk arrijnë të përmbushin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.<sup>38</sup> Mbrojtja e Selimit parashtron gjithashtu se Kërkesa e ZPS-së për modifikime specifike nuk arrin të bëjë mjaftueshëm dallimin midis të akuzuarve veç e veç, dhe nuk arrin të marrë parasysh veç e veç kuadrin e shkeljeve të tyre të

---

<sup>33</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 10, 11, 14.

<sup>34</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 11.

<sup>35</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 12, 13.

<sup>36</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 15, 19, 27.

<sup>37</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 15-31.

<sup>38</sup> Përgjigja e Selimit, para. 2.

pretenduara.<sup>39</sup> Mbrojtja e Selimit parashtron se atyre nuk iu dha koha ose materiali i nevojshëm për përgjigje të plotë ndaj thelbit të pretendimeve të ZPS-së dhe se ka gjasë të jenë të nevojshme parashtrime të mëtejshme.<sup>40</sup>

17. Mbrojtja e Selimit parashtron gjithashtu se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte mjaftueshëm pretendimet kundër z. Selimi, meqë ZPS-ja i atribuon atij si veprime ashtu edhe synime të cilat nuk mbështeten nga materialet bashkëlidhur Kërkesës.<sup>41</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se modifikimet e kërkuara për kushtet e paraburgimit shkelin të drejtat e z. Selimi sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNj"),<sup>42</sup> nuk përputhen me Udhëzuesin e Punës për Rregulloren e Paraburgimit,<sup>43</sup> dhe se janë shproporcionale dhe të papërligjura.<sup>44</sup> Mbrojtja e Selimit kërkon që Trupi Gjykses të hedhë poshtë kërkesën e ZPS-së në tërësi.<sup>45</sup> Mbrojtja e Selimit parashtron gjithashtu se masat e propozuara cenojnë të drejtat e fëmijëve të z. Selimi,<sup>46</sup> dhe ai kërkon që Trupi Gjykses të ndryshojë kushtet e përkohshme që t'i lejojë z. Selimi vizitën e familjes së tij midis 25 dhe 28 nëntor 2023.<sup>47</sup>

18. Mbrojtja e Veselit parashtron se ZPS-ja nuk ka arritur të mbështesë mjaftueshëm pretendimin se z. Veseli tentoi të komprometonte integritetin e procesit gjyqësor.<sup>48</sup> Mbrojtja e Veselit parashtron se në qoftë se bisedat e incizuara merren parasysh në tërësi, ato në fakt tregojnë të kundërtën, konkretisht se z. Veseli ka respektuar udhëzimet e Trupit Gjykses dhe nuk ka tentuar të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve ose

---

<sup>39</sup> Përgjigja e Selimit, para. 3, 38-40.

<sup>40</sup> Përgjigja e Selimit, para. 4-8.

<sup>41</sup> Përgjigja e Selimit, para. 9-30.

<sup>42</sup> Përgjigja e Selimit, para. 31-45.

<sup>43</sup> Përgjigja e Selimit, para. 34-35.

<sup>44</sup> Përgjigja e Selimit, para. 36-37, 41-45.

<sup>45</sup> Përgjigja e Selimit, para. 56(b).

<sup>46</sup> Përgjigja e Selimit, para. 46-48.

<sup>47</sup> Përgjigja e Selimit, para. 49-54.

<sup>48</sup> Përgjigja e Veselit, para. 2, 4, 7, 14-15.

ndaj integritetit të procesit gjyqësor.<sup>49</sup> Mbrojtja e Veselit parashtron se pjesëmarrja e z. Veseli në vizitat e të bashkakuzuarve ishin të paqëllimshme dhe të lejueshme sipas kushteve aktuale të paraburgimit.<sup>50</sup> Mbrojtja e Veselit parashtron se pretendimet e ZPS-së për ndërhyrje bazohen vetëm në deduksione të pambështetura dhe në thënie të të tjerëve të cilat burojnë nga rrëfimi i një burimi anonim.<sup>51</sup> Mbrojtja e Veselit parashtron gjithashtu se Trupi Gjyqësor duhet të shqyrtojë kushtet e propozuara të paraburgimit veç e veç.<sup>52</sup> Mbrojtja e Veselit parashtron se Kërkesa e ZPS-së duhet të hidhet poshtë në tërësi.<sup>53</sup>

19. Parashtrimi i Mbrojtjes së Krasniqit përqendrohet në kërkesën e ZPS-së në lidhje me vizitorë të përbashkët dhe raportim për vizita.<sup>54</sup> Mbrojtja e Krasniqit thekson se nuk është paraqitur asnjë provë që sugjeron se z. Krasniqi ka treguar në mënyrë të palejueshme informacion konfidencial ose se ka tentuar të ndërhyjë ndaj ndonjë dëshmitari, dhe se Kërkesa nuk paraqet pretendime se z. Krasniqi ka marrë pjesë në sjellje kundërvajtëse.<sup>55</sup> Mbrojtja e Krasniqit parashtron se, duke marrë parasysh këto rrethana, asnjë kufizim shtesë nuk gjykohej të jetë i domosdoshëm ose proporcional lidhur me z. Krasniqi, dhe se kushtet e propozuara rrjedhimisht do të shkelnin të drejtat e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së.<sup>56</sup> Mbrojtja e Krasniqit kundërshton konkretisht kushtet e propozuara që do të ndalonin vizita nga persona të cilët kanë vizituar tre të akuzuarit, meqë ndër ta ka persona të ndryshëm për të cilët nuk dyshohet se kanë kryer sjellje kundërvajtëse, si dhe anëtarë të ekipit të Mbrojtjes së Krasniqit.<sup>57</sup> Mbrojtja e Krasniqit thotë gjithashtu se është e gatshme të sigurojë vullnetarisht që anëtarë të

---

<sup>49</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 6, 21-35, 48-50.

<sup>50</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 36-39.

<sup>51</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 41, 51-53.

<sup>52</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 54.

<sup>53</sup> Përgjigjja e Veselit, para. 58.

<sup>54</sup> Përgjigjja e Krasniqit, para. 1.

<sup>55</sup> Përgjigjja e Krasniqit, para. 3.

<sup>56</sup> Përgjigjja e Krasniqit, para. 4-19.

<sup>57</sup> Përgjigjja e Krasniqit, para. 10-14.

Mbrojtjes së Krasniqit të mos vizitohet tre të akuzuarit në objektin e paraburgimit në asnjë mënyrë në të ardhmen.<sup>58</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

20. Sipas nenit 3(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta) dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Nenet 3 dhe 8 të KEDNJ-së, mbrojnë përkatësisht të drejtën për të mos u torturuar ose trajtuar ose ndëshkuar në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

21. Sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80(1) të Rregullores, Dhomat e Specializuara marrin masa për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre.

22. Sipas nenit 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullës 116(1) të Rregullores, Trupi Gjykses merr vazhdimisht të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit dhe mbrojtjen e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe viktimave.

23. Sipas rregullave 56, 57(2) dhe 116(4)(d), me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, të informacionit konfidencial apo të integritetit të procesit, Trupi Gjykses mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër të tjera vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale mbi komunikimet e të paraburgosurit dhe sipas nenit 1(3) të Udhëzuesit të Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, rregullat e tij nuk ndikojnë, dhe janë në varësi të urdhrave apo vendimve të Trupit Gjykses sipas rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

24. Palët dhe pjesëmarrësit kanë detyrim të përgjithshëm të mos u bëjnë të ditur palëve të treta dokumente ose informacionin konfidencial lidhur me procesin

---

<sup>58</sup> Përgjigjja e Krasniqit, para. 14.

gjyqësor.<sup>59</sup> Në veçanti, një palë ose pjesëmarrës nuk i zbulon një palë të tretë identitetin e dëshmitarit të mbrojtur. Këtë mund ta bëjnë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur zbulimi është i domosdoshëm drejtpërdrejt dhe konkretisht për përgatitjen dhe paraqitjen e provave të tyre,<sup>60</sup> dhe edhe në ato raste nuk i zbulon palës së tretë se një dëshmitar i mbrojtur është i përfshirë në aktivitete të DHSK-së/ZPS-së ose llojin e përfshirjes.<sup>61</sup>

#### IV. DISKUTIM

##### A. ASPEKTE PARAPRAKE

###### 1. Paanshmëria

25. Sa u përket parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me paanshmërinë,<sup>62</sup> Trupi Gjyqësor vë në dukje se kushtet dhe lloji i paraburgimit për katër të akuzuarit janë përgjegjësi e Trupit Gjyqësor.<sup>63</sup> Për përmbushjen e përgjegjësisë e veta sipas Ligjit, Trupit Gjyqësor duhet t'i paraqitet informacion relevant për të marrë vendime lidhur me këto aspekte. Ky informacion është relevant dhe do të merret parasysh vetëm në lidhje me aspektin e paraburgimit dhe për marrje të vendimit lidhur me kushtet e tij. Sugjerimi se njohja e Trupit Gjyqësor me këtë material do të dëmtonte paanshmërinë ose perceptimin e paanshmërisë është i pabazë.

---

<sup>59</sup> Shih përgjithësisht F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale apo Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar* ("Vendimi Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial"), 24 qershor 2022, para. 212(I)(a)

<sup>60</sup> Vendimi Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial, para. 212(I)(e).

<sup>61</sup> Vendimi Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial, para. 212(I)(f).

<sup>62</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 12.

<sup>63</sup> Shih nenin 40(2) dhe (6) të Ligjit; rregullat 56, 57(2), dhe 116(1) dhe (4)(d).

## 2. Koha e kufizuar dhënë të akuzuarve për t'u përgjigjur

26. Mbrojtja ka theksuar faktin që afati për të bërë parashtrime ishte tejet i shkurtër.<sup>64</sup> Trupi Gjykes në fakt ka theksuar nevojën për shpejtësi në këtë aspekt dhe mori parasysh faktin se kërkesa e Mbrojtjes për qasje në informacion të caktuar aktualisht është në shqyrtim e sipër prej Gjykatësit të Vetëm.<sup>65</sup> Nevoja për shpejtësi e theksuar lidhur me këtë aspekt është e qartë nga rrethanat në të cilat bazohet. Megjithatë, Trupi Gjykes ka mbajtur parasysh se afati i shkurtër mund të ketë ndikuar në aftësinë e Mbrojtjes për të shqyrtuar të gjithë materialin përkatës, përpara se të bënte parashtrime. Në rast se Mbrojtja zbulon informacion juridikisht thelbësor për vendimin e Trupit Gjykes, pasi të ketë shqyrtuar materialin, ajo mund të kërkojë rishikim të vendimit të Trupit Gjykes.

27. Megjithatë, Trupi Gjykes vë në dukje se, ndërsa Mbrojtja e z. Thaçi, Selimi, dhe Krasniqi iu përmbajtën afatit të caktuar nga Trupi Gjykes, Mbrojtja e Veselit dorëzoi Përgjigjen e saj jashtë afatit.<sup>66</sup> Megjithëse, Trupi Gjykes normalisht do të refuzonte të shqyrtonte parashtrime të paraqitura jashtë afatit, duke pasur parasysh kohën e kufizuar dhënë Mbrojtjes për trajtim të kësaj çështjeje, ai do të ushtrojë diskrecionin sipas rregullës 9(5)(b) për pranimit të Përgjigjes së Veselit si të dorëzuar në mënyrë të duhur, me gjithë vonesën.

## 3. Kërkesa urgjente e Mbrojtjes së Selimit për vizitë familjare

28. Trupi Gjykes vëren se kërkesa urgjente e Mbrojtjes së Selimit është e tejkaluar, sepse vizita e kërkuar ishte planifikuar për 25-28 nëntor.<sup>67</sup> Megjithatë, Trupi Gjykes

---

<sup>64</sup> Përgjigjja e Thaçit, para. 2; Përgjigjja e Selimit, para. 7-8; dhe Përgjigjja e Veselit, para. 8.

<sup>65</sup> *Shih* Përgjigjen e Thaçit, para. 1.

<sup>66</sup> Të dhënat lidhur me protokollimin pasqyrojnë se Përgjigjja e Veselit u pranua nga Njësia për Administrimin e Gjykatës në orën 17:42 më 22 nëntor 2023.

<sup>67</sup> Përgjigjja e Selimit, para. 49-54.

vë në dukje se Vendimi i Përkohshëm vendosi vetëm ndalim të përkohshëm për vizita familjare, dhe se ky ndalim modifikohet nga kushtet e vendimit aktual.

#### 4. Masat në lidhje me z. Krasniqi

29. Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtjen e Krasniqit se nuk u dorëzua asnjë provë që sugjeronte se z. Krasniqi shkëmbeu në mënyrë të palejueshme informacion konfidencial me vizitorët, se tentoi të ndërhynte tek dëshmitarët, ose se u soll në mënyrë të papërshtatshme në objektin e paraburgimit.<sup>68</sup> Për këtë arsye, asnjë nga masat e përcaktuara më poshtë nuk synojnë të kufizojnë kushtet e paraburgimit për z. Krasniqi bazuar në ndonjë parregullsi të kryer prej tij. Megjithatë, disa nga masat e përcaktuara më poshtë, mund të kenë ndikim mbi të, duke qenë se janë të domosdoshme për garantimin e efektshmërisë së masave të vendosura në lidhje me tre të akuzuarit. Trupi Gjykses është bindur se këto masa janë të domosdoshme dhe proporcionale dhe përputhen me të drejtat e z. Krasniqi.

#### 5. Qëllimi i masave

30. Masat e miratuara më poshtë, nuk synojnë të jenë ndëshkim dhe nuk shërbejnë si ndëshkim për sjelljet të cilat u atribuohen të akuzuarve. Këto masa shërbejnë vetëm për të parandaluar nxjerrjen e palejueshme të informacionit konfidencial, përfshirë të identiteteve të dëshmitarëve të mbrojtur, dhe për të garantuar integritetin e procesit gjyqësor. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses vë në dukje se shumë nga garancitë e parapara në Udhëzuesit e Punës të Zyrës Administrative për paraburgimin janë *privilegje* që tejkalojnë të drejtat të cilat i gëzojnë të paraburgosurit sipas të drejtave themelore. Rrjedhimisht, kufizimi i tyre nuk është *domosdoshmërisht* i papajtueshëm me mbrojtjen efektive të të drejtave të të paraburgosurve. Këto privilegje konkretisht janë objekt i kufizimeve të domosdoshme dhe proporcionale që mund të vendosen

---

<sup>68</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 3.

lidhur me to, në mënyrë që të mbrohen të drejtat dhe siguria e të tjerëve, sidomos e viktimave dhe dëshmitarëve.

## B. KONTEKSTI I VENDIMIT

31. Trupi Gjykses vë në dukje se më parë ka konstatuar se në Kosovë ekziston një atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të kësaj çështjeje gjyqësore dhe të çështjeve të tjera në Dhomat e Specializuara.<sup>69</sup> Gjykata e Apelit ka konfirmuar faktorët kontekstualë që mund të jenë relevantë gjatë vlerësimit të paraburgimit.<sup>70</sup> Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se ndër të tjera tre të akuzuarit kanë marrë informacion për 40 dëshmitarët e parë dhe më shumë, dhe se tre të akuzuarit do të vazhdojnë të marrin informacion të tillë në lidhje me dëshmitarë të ardhshëm të tjerë. Trupi Gjykses ka konstatuar më parë se këto nxjerrje të informacionit shtojnë rrezikun që informacioni i ndjeshëm lidhur me dëshmitarë të bëhet i njohur për publikun, para se dëshmitarët në fjalë të japin dëshmi.<sup>71</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se me gjithë përpjekjet për mbrojtje të dëshmitarëve, dëshmitarët në këtë çështje gjyqësore janë ankuar për ndërhyrje ose tentim për ndërhyrje. Trupi Gjykses do të marrë të gjitha masat të cila përputhen me të drejtat e të akuzuarve, për të siguruar mospërsëritjen e këtyre rasteve dhe marrjen e të gjithë hapave për uljen e këtij rreziku.

32. Trupi Gjykses ka konstatuar më parë se tre të akuzuarit kanë: (i) interesin dhe aftësinë të ndërhyjnë në procesin gjyqësor; (ii) pozita me ndikim në Kosovë që iu mundësojnë mbështetjen e simpatizuesve; dhe (iii) duke pasur parasysh gjykimin në

---

<sup>69</sup> *Shih për shembull* F01720, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 16 gusht 2023, para. 21; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses, *Aktgjykimi*, 19 janar 2023, para. 57. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.

<sup>70</sup> IA017/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit Lidhur me Rishikimin e Paraburgimit*, 5 prill 2022, konfidencial, para. 43. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA017/F00011/RED.

<sup>71</sup> *Shih për shembull*, F01302, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 17 shkurt 2023, konfidencial, para. 25. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01302/RED.



vijim e sipër, njohjen gjithnjë e më të plotë me akuzat e rënda kundër tyre; dhe (iv) sa i përket z. Thaçi, ai u orvat të dëmtonte Dhomat e Specializuara dhe u ofroi përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja.<sup>72</sup>

## C. PRETENDIMET PËR SHKELJE DHE RREZIQET E PARAQITURA

### 1. Ndërrhyrja ndaj dëshmitarëve të ZPS-së

33. Trupi Gjykues u kthehet tani fakteve dhe rrethanave të pretenduara të paraqitura së fundi nga ZPS-ja. ZPS-ja identifikon tre dëshmitarë të saj të cilët u kontaktuan nga persona të cilët u përpoqën t'i bindnin dëshmitarët të tërhiqnin ose të ndryshonin dëshmitë e tyre për t'i bërë ato më të favorshme për tre të akuzuarit.<sup>73</sup> Në secilin rast, dëshmitari u kontaktua brenda disa muajsh pas nxjerrjes së identiteteve të tyre për tre të akuzuarit.<sup>74</sup> Në secilin rast, personi ose personat që kontaktuan dëshmitarët pretenduan se po vepronin në emër të një ose më shumë prej tre të akuzuarve,<sup>75</sup> ose në emër të dikujt që kishte lidhje me tre të akuzuarit.<sup>76</sup> Megjithatë, në secilin rast personi ose personat që i kontaktuan nuk figurojnë se kanë vizituar të

---

<sup>72</sup> *Shih për shembull F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm, 22 janar 2021, konfidencial, para. 41. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00177/RED; F01111, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit, 18 nëntor 2022, konfidencial, para. 26-27. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01111/RED; F00576, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim në lidhje me Vendimin mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kthyer për Rishqyrtim dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 23 nëntor 2021, konfidencial, para. 52. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 dhjetor 2021, F00576/RED; Vendimi Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial, para. 118 (ku theksohet se “ekziston një atmosferë e frikësimit dhe ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve në lidhje me proceset penale që kanë të bëjnë me ish-anëtarë të UÇK-së, dhe se të akuzuarit në çështjen në fjalë, që kanë qenë anëtarë me funksione të larta në UÇK-së dhe kanë pasur poste të tjera me influencë, vazhdojnë të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm.”)*

<sup>73</sup> Kërkesa, para. 8-20.

<sup>74</sup> Kërkesa, para. 8, 13, 15.

<sup>75</sup> *Shih Kërkesën para. 8 (që pretendohet se u udhëzuan nga z. Thaçi dhe z. Veseli), 13 (kërkon të bindë dëshmitarin të tërheqë dëshminë kundër z. Selimi, në veçanti).*

<sup>76</sup> Kërkesa, 8, 9, 13, 15.

akuzuarit gjatë kohës kur të akuzuarve iu tregua informacioni lidhur me dëshmitarët dhe kur u tentua ndërhyrja.<sup>77</sup>

34. Trupi Gjykses nuk ka konstatuar se këto tentime për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve të ZPS-së mund t'u atribuohen të akuzuarve, si bashkëveprim ose veprim individual. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se informacioni lidhur me identitetet e dëshmitarëve të ZPS-së dhe rendit sipas të cilit thirren ata dihet vetëm prej një numri të kufizuar personash të përfshirë në këtë proces gjyqësor. Trupi Gjykses vë në dukje më tej se këto tentime paraqesin një sfidë të madhe për integritetin e procesit gjyqësor, gjë që Trupi Gjykses nuk do ta tolerojë.

## **2. Nxjerrja e informacionit të mbrojtur dhe konfidencial nga tre të akuzuarit**

35. ZPS-ja i ka dorëzuar Trupit Gjykses transkriptet e komunikimeve midis z. Thaçi,<sup>78</sup> z. Selimi,<sup>79</sup> z. Veseli<sup>80</sup> dhe vizitorëve të tyre përkatës gjatë vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit. Në pjesët përkatëse të çdo transkripti, duket se të akuzuarit u treguan vizitorëve informacion konfidencial të marrë në kontekst të procesit gjyqësor ose të nxjerrë gjatë dhënies së dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>81</sup>

36. Trupi Gjykses përsërit se të akuzuarit e kanë të ndaluar të zbulojnë ose të diskutojnë informacion që është objekt i masave mbrojtëse, me persona të tjerë, përveçse me mbrojtësin e tyre ose me anëtarë të ekipit të Mbrojtës, sidomos emrat dhe hollësitë e dëshmitarëve të ZPS-së, informacion konfidencial dhe/ose përmbajtjen e

---

<sup>77</sup> Kërkesa, para. 10, 14, 16.

<sup>78</sup> F01933/A04, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 4 e Kërkesës Urgjente të Prokurorisë për Modifikim të Kushteve të Paraburgimit* ("Shtojca 4 e Kërkesës"), 17 nëntor 2023, konfidenciale, f. 183-186.

<sup>79</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, f. 172.

<sup>80</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, f. 240-242.

<sup>81</sup> *Shih* Shtojcën 4 të Kërkesës, f. 172, 183-186, 240-242; *shih gjithashtu* F01948, Prokurorja e Specializuar, *Sqarim i Prokurorisë në lidhje me Parashtrimin F01933*, 23 nëntor 2023, konfidencial.

dëshmisë së dhënë në seancë private ose të mbyllur.<sup>82</sup> Këtu përfshihet informacioni i cili mund të identifikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, dëshmitarët të cilët janë objekt i masave mbrojtëse. Nxjerrja e paautorizuar e informacionit për palë të treta përbën bazë për veprë penale sipas standardit ligjor në fuqi.<sup>83</sup>

37. Pa arritur në konstatim nëse sjellja e pasqyruar në transkriptet përbën veprë penale nga ana e tre të akuzuarve, Trupi Gjykes vë në dukje se, sa më lart bën të qartë rrezikun e konsiderueshëm që, në mungesë të masave të përshtatshme, tre të akuzuarit mund të nxjerrin informacion të privilegjuar për palë të treta të paautorizuara në mënyrë të palejueshme.

### 3. Udhëzimet e lëshuara nga z. Thaçi

38. ZPS-ja ka dorëzuar tri transkripte ku janë pasqyruar komunikimet midis z. Thaçi dhe vizitorëve jo të privilegjuar, gjatë të cilave janë diskutuar dëshmitë e dëshmitarëve konkretë që do të jepnin dëshmi.<sup>84</sup> Identitetet e dëshmitarëve në fjalë ishin të mbrojtura në atë kohë dhe z. Thaçi nuk ishte i autorizuar t'ua tregonte atë informacion palëve të treta të paautorizuara. Në secilin transkript duket se z. Thaçi i jep vizitorit udhëzime të cilat duhej t'ia kalonte dëshmitarit në lidhje me mënyrën dhe përmbajtjen e dëshmisë që pritej të jepej.<sup>85</sup> Në disa pjesë të transkriptit duket sikur z. Thaçi i tregon vizitorit deklaratën e mëparshme të dëshmitarit që pritej të jepte dëshmi, identiteti i të cilit ishte konfidencial.<sup>86</sup> Pjesët e tjera të transkriptit bëjnë të qartë se një nga vizitorët e z. Thaçi, i cili po merrte udhëzime, ka vizituar më parë dëshmitarët para se të jepnin dëshmi.<sup>87</sup>

---

<sup>82</sup> Vendimi Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial, para. 212(I)(a), (e), (f).

<sup>83</sup> *Shih* rregullën 82(6) të Rregullores; nenin 15 të Ligjit.

<sup>84</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, f. 43-44, 50-53, 218-222, 287-288, 298-299, 354-355.

<sup>85</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, f. 43-44, 50-53, 218-222, 287-288, 298-299, 354-355.

<sup>86</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, 287-288, 298-299, 354-355. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 34.

<sup>87</sup> Shtojca 4 e Kërkesës, f. 266-273. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 35.

39. Trupi Gjykses nuk ka konstatuar nëse sjellja e përshkruar më lart përbën kryerje të një veprë penale nga z. Thaçi. Megjithatë, Trupi Gjykses ka konstatuar se veprimet e përshkruara më lart tregojnë një rrezik të konsiderueshëm se, pa vendosje të masave të përshtatshme, z. Thaçi mund të kryejë sjellje të palejueshme e cila mund të rrezikojë sigurinë e dëshmitarëve dhe/ose integritetin e procesit gjyqësor.

#### **4. Lloji individual dhe kolektiv i sjelljes bazë**

40. Gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të masave të kërkuara, Trupi Gjykses ka marrë parasysh rrethanat dhe veprimet individuale të tre të akuzuarve në fjalë. Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses ka mbajtur parasysh faktin që, marrë së bashku, efekti i veprimeve të tyre ka rritur rreziqet që shoqërojnë nxjerrjen e palejueshme të informacionit konfidencial dhe rrjedhimisht ka krijuar një sërë opsionesh që mund të rezultojnë në ndërhyrje në procesin gjyqësor nga palë të treta.

#### **5. Përfundim**

41. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar se kushtet aktuale të paraburgimit janë të pamjaftueshme për të ulur rrezikun që tre të akuzuarit të kryejnë sjellje që mund të ndërhyjë në procesin gjyqësor dhe/ose të paraqesë rrezik për sigurinë e dëshmitarëve.

42. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të vlerësojë kërkesën për masat nga ZPS-ja duke pasur parasysh faktorët dhe rrethanat e përshkruara më lart, por edhe duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të të akuzuarve<sup>88</sup> dhe domosdoshmërinë për të garantuar mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve dhe integritetin e procesit

---

<sup>88</sup> *Shih* Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut ("KEDNJ-") nenet 3, 8; Rregullat Standarde Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (UN Doc. A/Res/70/175); Rekomandimet Rec(2006)2-rev e Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me Rregulloren Evropiane të Burgimit (të miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006, e rishikuar dhe ndryshuar më 1 korrik 2020).

gjyqësor. Gjatë kryerjes së vlerësimit, Trupi Gjykes do të shqyrtojë sistemin e paraburgimit në tërësi, domosdoshmërinë e masave të kërkuara, proporcionalitetin e tyre, si dhe ndikimin e gjithsejtë të këtyre masave mbi të drejtat e të akuzuarve.

#### D. VEÇIMI I TRE TË AKUZUARVE NGA TË PARABURGOSURIT E TJERË

43. ZPS-ja sugjeron se veçimi i tre të akuzuarve nga të gjithë të paraburgosurit e tjerë aktualisht në objektin e paraburgimit është i domosdoshëm për të trajtuar rreziqet e diskutuara më lart.<sup>89</sup> Trupi Gjykes vë në dukje se veçimi i një të akuzuari nuk është vetvetiu në kundërshtim me nenin 3 të KEDNj-së,<sup>90</sup> dhe është masë që njihet nga sistemi juridik i Dhomave të Specializuara si masë në dispozicion për të garantuar integritetin e procesit gjyqësor kundër të akuzuarve.<sup>91</sup> Megjithatë, kjo masë duhet të jetë e domosdoshme për sigurimin e qëllimit legjitim – si për arsye sigurie, disipline ose arsye mbrojtëse të tjera.<sup>92</sup>

44. Trupi Gjykes konstaton se duhet të merren parasysh faktorë shtesë, edhe pse veçimi i tre të akuzuarve do të siguronte që ata nuk do të mund të përdornin të paraburgosurit e tjerë si ndërmjetësues për përhapje të informacionit konfidencial. Në veçanti, Trupi Gjykes vë në dukje se deri tani nuk ka asnjë tregues se ndonjëri prej tre të akuzuarve tentoi të shfrytëzonte një të paraburgosur tjetër për ndërhyrje në proces gjyqësor ose nxjerrje të informacionit konfidencial. Nuk ka tregues se ndonjëri prej të paraburgosurve tregoi gatishmëri për kësi sjelljesh në emër të tyre. Së dyti, këto masa do të kishin ndikim cenes të rëndë për të drejtat e tre të akuzuarve. Së fundi,

<sup>89</sup> Kërkesa, para. 2(h).

<sup>90</sup> European Court of Human Rights (“ECtHR”), *A.T. v. Estonia (No. 2)*, no. 70465/14, [Judgment](#), (“*A.T. v. Estonia (No. 2)*”), 13 November 2018, para. 72; *Öcalan v. Turkey (No. 2)*, nos. 24069/03, 197/04, 6201/06 and 10464/07, [Judgment](#) (“*Öcalan v. Turkey (No. 2)*”), 18 March 2014, para. 104; *Rohde v. Denmark*, no. 69332/01, [Judgment](#) (“*Rohde v. Denmark*”), 21 July 2005, para. 93.

<sup>91</sup> Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative mbi Rregulloren e Paraburgimit, rregulla 43(3)(c).

<sup>92</sup> ECtHR, *Ramirez Sanchez v. France* [GC], no. 59450/00, [Judgment](#) (“*Ramirez Sanchez v. France*”), 4 July 2006, para. 123; *Öcalan v. Turkey (No. 2)*, para. 107; *Babar Ahmad and Others v. the United Kingdom*, no. 24027/07 and 4 others, [Judgment](#) (“*Babar Ahmad and Others v. the United Kingdom*”), 10 April 2012, para. 208.

Trupi Gjykses gjykon se qëllimi legjitim që kërkohet mund të arrihet me masa më pak ndërhyrëse ndaj të drejtave të personave në fjalë dhe se rrjedhimisht atyre duhet t'u jepet përparësi në raport me veçimin. Rrjedhimisht, mbi bazën e informacionit aktual paraqitur Trupit Gjykses, ai nuk është bindur se masa e veçimit është e domosdoshme dhe/ose proporcionale në këtë fazë.

#### E. KUFIZIMET E VIZITAVE DHE KOMUNIKIMEVE ME TELEFON PËR TRE TË AKUZUARIT

45. Masat për kufizimin e kontakteve të një të paraburgosuri me botën e jashtme nuk janë *në vetvete* në mospërputhje me nenin 8 të KEDNj-së.<sup>93</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas nenit 8 të KEDNj-së, ndërhyrja në të drejtën e një të paraburgosuri për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe letërkëmbimit, mund të jetë e përligjur në qoftë se është “në përputhje me ligjin”, bëhet për një ose më shumë qëllime legjitime të renditura në nenin 8(2) të KEDNj-së dhe është e domosdoshme dhe proporcionale me rrethanat.<sup>94</sup> Këto masa nuk duhet të ndikojnë në thelbin e të drejtave themelore.

46. Kriteri sipas të cilit çdo kufizim duhet të jetë “në përputhje me ligjin” do të thotë se masat duhet të bazohen në dispozitat ligjore përkatëse tek të cilat personi në fjalë duhet të ketë qasje dhe efekti i të cilave duhet të jetë i parashikueshëm.<sup>95</sup> Për sa i takon kriterit të domosdoshmërisë, ai nënkupton që ndërhyrja duhet të përkohet me një nevojë të ngutshme shoqërore dhe, në veçanti, të jetë proporcionale me qëllimin ose qëllimet legjitime që synohet të arrihen.<sup>96</sup> Gjithsesi, Trupi Gjykses thekson se, në

<sup>93</sup> ECtHR, *Khoroshenko v. Russia* [GC], no. 41418/04, [Judgment](#) (“*Khoroshenko v. Russia*”), 30 June 2015, para. 123; *Piechowicz v. Poland*, no. 20071/07, [Judgment](#) (“*Piechowicz v. Poland*”), 17 April 2012, para. 212.

<sup>94</sup> Siguria kombëtare, siguria publike, mirëqenia ekonomike, parandalimi i trazirave dhe krimin, mbrojtja e shëndetit ose moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve (neni 8(2) i KEDNj-së).

<sup>95</sup> *Khoroshenko v. Russia*, para. 110.

<sup>96</sup> ECtHR, *Khoroshenko v. Russia*, para. 118.

rrethanat e paraburgimit, vazhdimi i kontakteve me të afërmit e ngushtë është element thelbësor i respektimit të së drejtës së të paraburgosurit për jetë familjare.<sup>97</sup>

47. Në lidhje me kriteret e përcaktuara në nenin 8 të KEDNj-së, Trupi Gjykses vëren se rregullat 56(6) dhe 116(4)(d) të Rregullores, së bashku me rregulloret e brendshme të Zyrës Administrative,<sup>98</sup> parashikojnë mundësinë e miratimit të kufizimeve në lidhje me kontaktet e të akuzuarit.

48. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se në përputhje me rregullën 56(6), pa paragjykuar nenin 21(4)(c), në bazë të një kërkesë ose *proprio motu*, dhe me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, të informacionit konfidencial apo të integritetit të procesit gjyqësor, ai mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër të tjera vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale mbi komunikimet e të paraburgosurit.

### **1. Kufizimet specifike lidhur me komunikime dhe vizitorë të përbashkët**

49. ZPS-ja sugjeron që të gjitha komunikimet jo të privileguara të tre të akuzuarve të lejohen vetëm për anëtarë të familjes dhe zyrtarë konsullorë të përfshirë në një listë të miratuar paraprakisht,<sup>99</sup> dhe se tre të akuzuarit nuk duhet të kenë vizitorë të përbashkët me të paraburgosurit e tjerë.<sup>100</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, kjo mund të ndikojë në vizitorë të mundshëm në mënyrë rastësore dhe pa dallim, dhe rrjedhimisht këto masa janë shproporcionale.

---

<sup>97</sup> ECtHR, *Messina v. Italy (No. 2)*, no. 25498/94, [Judgment](#), 28 September 2000, para. 61; [Onoufriou v. Cyprus](#), para. 91; *Horych v. Poland*, no. 13621/08, [Judgment](#), 17 April 2012, para. 122; [Piechowicz v. Poland](#), para. 212.

<sup>98</sup> Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, nenet. 6-7, 12-13, 15, 17, 19; Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, nenet 14-18.

<sup>99</sup> Kërkesa, para. 2(b).

<sup>100</sup> Kërkesa, para. 2(f).

## 2. Vizitat personale jo të privileguara

50. ZPS-ja propozon refuzim të plotë të të gjitha vizitave personale jo të privileguara për tre të akuzuarit.<sup>101</sup> Trupi Gjykes konstaton se, megjithëse ky qëndrim do t'u pamundësonte tre të akuzuarve nxjerrjen drejtpërdrejt të materialit konfidencial në këtë kontekst, sipas mendimit të Trupit Gjykes ndalimi i plotë i të gjitha vizitave jo të privileguara nuk është proporcional në këtë fazë. Kjo masë do të krijonte gjithashtu një prezumim të përgjithshëm të parregullsisë nga ana e vizitorëve jo të privilegjuar. Mund të zbatohen masa të tjera, që përputhen më shumë me të drejtat e të akuzuarve, në mënyrë që vizitorët jo të privilegjuar t'i nënshtrohen kontrollit më të kujdesshëm, gjë që përputhet si me të drejtat e të akuzuarve ashtu edhe me qëllimin që synohet të arrihet me këto masa.

51. Së pari, përpara Vendimit të Përkohshëm të Trupit Gjykes, shefi i Njesisë së Paraburgimit ("NJP") rishikon dhe shqyrton diskrecionin për miratimin ose refuzimin e vizitës.<sup>102</sup> Trupi Gjykes konstaton se tash e tutje, të gjitha vizitat personale jo të privileguara për tre të akuzuarit varen nga miratimi paraprak i Administratores, në mënyrë që gjatë marrjes së vendimit për miratim të një vizite të caktuar, të mund të merren parasysh të gjithë faktorët përkatës juridikë, praktikë dhe të sigurisë. Është i vetëkuptueshëm këshillimi me shefin e Njesisë së Paraburgimit përpara marrjes së një vendimi të tillë. Kur është e nevojshme, Administratorja këshillohet edhe me ZPS-në për të përcaktuar nëse ka tregues se ndonjë person ka kryer ose mund të kryejë sjellje të papajtueshme me kërkesën e tij/të saj për vizitë jo të privilegjuar te cilido prej të akuzuarve.

52. Trupi Gjykes konstaton se duhet të vendoset një sistem që përqendrohet në identifikimin dhe përjashtimin vetëm të personave, të cilët mund të përbëjnë rrezik për integritetin e procesit gjyqësor ose që kryejnë sjellje të papajtueshme me

---

<sup>101</sup> Kërkesa, para. 2(d).

<sup>102</sup> Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 12(1).



Rregulloren e Njesisë së Paraburgimit. Kompetencat e Administratores dhe të shefit të paraburgimit për refuzim të vizitës përcaktohen në nenet 7 dhe 12 të Udhëzuesit të Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet. Krahas kësaj, Trupi Gjykses udhëzon Administratoren të refuzojë vizita personale kur ajo, gjatë ushtrimit të diskrecionit të vet, konstaton se ka tregues të besueshëm se personi në fjalë ka kryer ose mund të kryejë sjellje të papajtueshme me integritetin e procesit gjyqsor dhe/ose rregullat e paraburgimit.

53. Të akuzuarit mund t'i paraqesin Trupit Gjykses kundërshtim ndaj vendimit për refuzim të një vizite brenda shtatë ditësh pas marrjes së njoftimit për refuzimin nga Administratorja. Kërkesa për rishikim gjyqsor të vendimit bëhet në përputhje me nenin 9(2)-(6) të Udhëzuesit të Punës për Paraburgim të Zyrës Administrative: Ankesat (KSC-BD-11-Rev1).

### 3. Kushtet gjatë vizitave

54. ZPS-ja ka identifikuar rrethana që ngrenë shqetësime gjatë vizitave në objektin e paraburgimit, ndër to: (i) muzikë në hapësirën për vizita;<sup>103</sup> (ii) të paraburgosur që nuk kanë vizitë hyjnë në hapësirën për vizita;<sup>104</sup> (iii) të paraburgosur që nuk kanë vizitë të pranishëm për një pjesë të vizitave;<sup>105</sup> dhe (iv) të paraburgosurit hyjnë në hapësirën për vizita me transkripte të materialeve të mbrojtura.<sup>106</sup>

55. Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të garantojë si në vijim: (i) tre të akuzuarit nuk duhet të takojnë më shumë se një vizitor në një vizitë (me përjashtim të vizitave nga bashkëshortet/partneret dhe fëmijë të cilët do ta bënin vizitën bashkërisht, por pa vizitorë të tjerë të pranishëm); (ii) në hapësirën për

---

<sup>103</sup> Kërkesa, para. 19.

<sup>104</sup> Kërkesa, para. 19.

<sup>105</sup> Kërkesa, para. 19.

<sup>106</sup> Kërkesa, para. 34.

vizita nuk do të ketë muzikë me volum të lartë ose zhurma të tjera të forta që mund të pengojnë komunikimet; (iii) i vetmi i paraburgosur me të cilin kontakton vizitori është i paraburgosur të cilin vizitori është lejuar ta vizitojë; të paraburgosurit nuk marrin pjesë në vizitat e të paraburgosurve të tjerë; (iv) një i paraburgosur nuk ka vizitë personale jo të privilegjuar në të njëjtën kohë me një të paraburgosur tjetër, ose në një afërsi kohe të tillë që u mundëson vizitorëve të komunikojnë me njëri-tjetrin ose me të paraburgosur të tjerë; (v) të paraburgosurit nuk hyjnë në hapësirën për vizita me dokumente ose materiale të privileguara ose konfidenciale që kanë lidhje me një çështje gjyqësore para Dhomave të Specializuara; (vi) të gjithë të paraburgosurit dhe vizitorët komunikojnë në mënyrë të dëgjueshme dhe nuk lejohen të fshehin pjesë të bisedës përmes pëshpërimit ose duke përdorur gjuhë të koduar;<sup>107</sup> (vii) në rast të shkeljes së këtyre dispozitave ose rregullave të tjera për vizitat, Administratorja dhe personat që veprojnë në emër të saj janë të autorizuar të përfundojnë menjëherë vizitën. Në raste kur vizita përfundohet parakohshëm për këtë arsye, Zyra Administrative njofton Trupin Gjyqësor menjëherë, dhe i dorëzon raportin mbi incidentin brenda pesë ditësh.

#### 4. Vizitat konsullore

56. Trupi Gjyqësor vë në dukje se vizitat konsullore janë vizita jo të privileguara.<sup>108</sup> Aktualisht, neni 20(2)(a) i Udhëzuesit të Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet thotë se vizitat konsullore kryhen brenda rrezes së shikimit, por jo brenda rrezes së dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Duke pasur parasysh se vizitat konsullore nuk janë të privileguara dhe duke pasur parasysh rrezikun ndaj integritetit të procesit gjyqësor të shpjeguar më lart, Trupi Gjyqësor urdhëron që

---

<sup>107</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 15(1) (që kërkon që të gjitha vizitat të kryhen brenda rrezes së dëgjimit të oficerit të paraburgimit).

<sup>108</sup> *Shih* rregullën 111 (ku komunikimet konsullore nuk identifikohen si të privileguara); Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 20(2).

për vizitat konsullore për cilindo prej tre të akuzuarve vlejné të njëjtat kushte si për vizita të tjera jo të privileguara, d.m.th., ato kryhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Vizitat konsullore për çdonjërin nga tre të akuzuarit nuk zgjasin më shumë se 45 minuta.

## 5. Mbikëqyrja aktive

57. Trupi Gjykues konstaton se mbikëqyrja aktive e të gjitha takimeve personale jo të privileguara (me përjashtim të vizitave konsullore me leje të duhur)<sup>109</sup> midis tre të akuzuarve dhe vizitorëve të tyre është e domosdoshme për të trajtuar shqetësimet e ngritura nga ZPS-ja dhe të pranuar nga Trupi Gjykues. Vizitat duhet të mbikëqyren nga një shqipfolës, në mënyrë që kjo masë të jetë efektive. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm për faktin që mbikëqyrja kërkon kohë dhe burime shtesë nga Zyra Administrative dhe NJP-ja.<sup>110</sup> Për të siguruar mbikëqyrjen efektive të tyre, Trupi Gjykues kufizon numrin e vizitave personale jo të privileguara të autorizuara për çdo muaj deri në pesë vizita, duke mos përfshirë vizitat konsullore dhe private.<sup>111</sup> Vizitat private në këtë kontekst janë vizitat për të akuzuarit nga bashkëshortet dhe/ose fëmijët. Zyra Administrative ka diskrecionin të kufizojë edhe më tej numrin e vizitave ose të kufizojë kohëzgjatjen e këtyre vizitave për të siguruar mbikëqyrjen efektive të tyre. Në raste kur Administratorja merr vendim për kufizimet, ajo njofton Trupin Gjykues në lidhje me të menjëherë.

---

<sup>109</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 20.

<sup>110</sup> *Shih* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 40.

<sup>111</sup> Shënim: Vizitat konsullore nuk përfshihen në kufizimin deri në pesë vizita.

## 6. Regjistri i vizitave personale jo të privileguara

58. Sikurse parashikohet nga rregulloret përkatëse,<sup>112</sup> shefi i paraburgimit do të mbajë një regjistër ku shënon të gjitha vizitat personale jo të privileguara, përfshirë emrin e vizitorit, emrin e të paraburgosurit, të dhënat për kontakt të vizitorit dhe adresën, orën dhe kohëzgjatjen e vizitës, dhe çdo informacion tjetër që shefi i paraburgimit e gjykon të rëndësishëm.<sup>113</sup> Administratorja do të kontrollojë regjistrin çdo javë për të vërtetuar, pas konsultimit me ZPS-në, nëse ekzistojnë rrethana që mund të tregojnë aktivitete të dyshimta. Kur lindin këto shqetësime, Administratorja njofton Trupin Gjykes menjëherë.

59. Masa konkrete (mbajtja dhe kontrollimi i regjistrin) vlen edhe për vizitat e z. z. Krasniqi. Sikurse u vu në dukje më lart, kjo nuk ka për synim të sugjerojë ndonjë parregullsi nga ana e z. Krasniqi, por ka për qëllim të sigurojë se masat e urdhëruara në lidhje me tre të akuzuarit të mund zbatohen në mënyrë efektive nga Administratorja nën mbikëqyrjen e Trupit Gjykes. Trupi Gjykes bindet se masa përputhet me mbrojtjen efektive të të drejtave të z. Krasniqi dhe është e domosdoshme dhe proporcionale në rrethanat aktuale.

## 7. Vizitat e anëtarëve të ekipit të Mbrojtjes të cilët nuk janë mbrojtës ose bashkëmbrojtës

60. Trupi Gjykes kujton se vetëm mbrojtësi dhe bashkëmbrojtësi i emëruar kanë të drejtën e vizitave të privileguara.<sup>114</sup> Vizitat nga anëtarë të tjerë të ekipit të mbrojtjes, kur nuk shoqërohen nga mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi nuk janë të

---

<sup>112</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 10(4)

<sup>113</sup> Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni. 16(4).

<sup>114</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, neni 6(5).

privileguara<sup>115</sup> dhe janë objekt i kufizimeve të përcaktuara më lart, përfshirë edhe miratimin e Zyrës Administrative.

61. Masat shitesë që kërkon ZPS-ja në lidhje me kufizimet e vizitave për anëtarë të ekipit të Mbrojtjes janë shproporcionale kundrejt rrezikut të përfshirë. Trupi Gjykses nuk disponon informacion që do të përlligjte këto masa.<sup>116</sup> Trupi Gjykses vë në dukje më tej se nëse miratohen, ato mund të kenë efekt të dëmshëm ndaj aftësisë së Mbrojtjes për t'u përgatitur. Rrjedhimisht, në këtë fazë, Trupi Gjykses refuzon miratimin e masave të tjera të kërkuara nga ZPS-ja lidhur me vizitat e anëtarëve të ekipit të Mbrojtjes.

## **8. Vizitat dhe komunikimet me videolidhje dhe me telefon**

62. Për vizitat dhe komunikimet me videolidhje dhe me telefon me tre të akuzuarit nevojitet miratim paraprak nga Administratorja për arsyet e shtjelluara në pjesët më lart.<sup>117</sup> Në lidhje me këtë, Administratorja udhëzohet të lejojë kontakte telefonike për tre të akuzuarit vetëm me persona të miratuar nga Administratorja.<sup>118</sup> Në veçanti, përpara se të lejojë thirrjet, Administratorja udhëzohet të sigurojë se bashkëbiseduesi i mundshëm nuk ka kryer sjellje të papajtueshme me integritetin e procesit gjyqësor ose mbrojtjen e informacionit konfidencial. Kur është e nevojshme, Administratorja duhet të këshillohet me ZPS-në për këtë aspekt. Kur Administratorja refuzon miratimin e thirrjes telefonike për një person, ajo informon menjëherë Trupin Gjykses për vendimin.

---

<sup>115</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, neni 9(4), (5).

<sup>116</sup> *Shih* Kërkesën, para. 47.

<sup>117</sup> *Shih më lart*, para. 51.

<sup>118</sup> *Shih* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 24. Trupi Gjykses vë në dukje se personat të cilët nuk janë "të afërm të ngushtë ose zyrtarë konsullorë", sikurse propozohet nga Administratorja, mund të kenë kontakte telefonike me tre të akuzuarit, në varësi të miratimit nga Administratorja.

63. Krahas asaj që u cek më lart, NJP-ja duhet të kërkojë një dokument identifikimi të vlefshëm në fillim të vizitës me videolidhje.<sup>119</sup> Gjatë shqyrtimit të kërkesave për vizita dhe komunikime me videolidhje dhe me telefon, Administratorja zbaton të njëjtat metoda dhe mbikëqyrje të përmendura më lart në kontekst të arsyeve për refuzim të vizitave personale.<sup>120</sup>

64. Ata që lejohen të komunikojnë me video ose me telefon me një nga tre të akuzuarit informohen se: (a) nuk janë të lejuar të diskutojnë informacion konfidencial ose të mbrojtur me të akuzuarin dhe mund të përballen me pasojat ligjore, në rast e bëjnë këtë; (b) nuk janë të lejuar të flasin në gjuhë të koduar dhe se komunikimi mund të përfundohet në rast se e bëjnë këtë; (c) nuk janë të lejuar të incizojnë bisedën ose t'i japin qasje në komunikim një pale të tretë.

65. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se praktika standarde lidhur me mbikëqyrjen e komunikimeve me telefon në objektin e paraburgimit është se shefi i paraburgimit mund të dëgjojë deri në dhjetë (10) për qind të të gjitha bisedave telefonike që incizohen digjitalisht çdo javë, të cilat përzgjidhen në mënyrë rastësore.<sup>121</sup> ZPS-ja kërkon që të gjitha komunikimet e tre të akuzuarve të mbikëqyren aktivisht nga një shqipfolës.<sup>122</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses kjo masë nuk është proporcionale kundrejt rrezikut në këtë fazë. Trupi Gjykses vë në dukje se në këtë kontekst nuk ka tregues se komunikimet me video ose audio janë shfrytëzuar në mënyrë të papajtueshme me integritetin e procesit gjyqësor. Gjithashtu, mbikëqyrja aktive e përgjithshme do të rëndonte më tej barrën mbi Zyrën Administrative dhe të NJP-së që nuk përlijet nga informacioni që Trupi Gjykses ka aktualisht.<sup>123</sup>

---

<sup>119</sup> *Shih* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 26.

<sup>120</sup> *Shih më lart*, para. 51-53.

<sup>121</sup> Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, Art. 17(3).

<sup>122</sup> Kërkesa, para. 2(c)(i)-(iii).

<sup>123</sup> *Shih* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 39(a), 43(a).

66. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Zyren Administrative të angazhohet në mbikëqyrjen aktive (gjë për të cilën njoftohen të akuzuarit) të vizitave dhe komunikimeve me audio dhe video kur Administratorja, gjatë ushtrimit të diskrecionit të saj ose me udhëzim të Trupit Gjykses kur është e nevojshme, e gjykon të nevojshme për të garantuar integritetin e procesit gjyqsor dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe/ose për të garantuar që tre të akuzuarit ose ata me të cilët kanë kontakt, të respektojnë masat e urdhëruara në këtë vendim.<sup>124</sup> Sikurse u cek më lart, Zyra Administrative kontakton ZPS-në, kur është nevojshme, për të identifikuar vizitorët për të cilët komunikimet me të akuzuarit duhet të mbikëqyren.

67. Ndër kushtet shtesë për vizitat me videolidhje dhe telefon dhe komunikimet lidhur me palë të tretë përfshihen: asnjë person i palajmëruar nuk merr pjesë në thirrje; (ii) asnjë person nuk lejohet të dëgjojë pasivisht thirrjen ose të marrë ose sigurojë përmbajtjen e thirrjes gojarisht ose tekstualisht<sup>125</sup>, përveç personit të lajmëruar; (iii) ndalohet përdorimi i funksionit *speaker* ose i një funksioni të ngjashëm në telefon; dhe (v) të paraburgosurit dhe kujtqo që komunikon me të paraburgosurin u ndalohet të bëjnë videoincizim ose audioincizim të vizitave dhe komunikimeve. Gjatë ushtrimit të kompetencës së saj diskrecionale dhe për të siguruar mbikëqyrjen efektive të këtyre komunikimeve, Administratorja mund të kufizojë numrin e thirrjeve/videolidhjeve dhe/ose kohëzgjatjen e tyre. Për këto vendime informohet menjëherë Trupi Gjykses.

68. Trupi Gjykses urdhëron Administratoren t'u japë punonjësve që kryejnë mbikëqyrjen udhëzimet dhe kompetencat e nevojshme për përfundimin e komunikimeve kur nuk respektohen rregullat përkatëse të këtij Vendimi. Sikurse

---

<sup>124</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se urdhri në fjalë, për tre të akuzuarit, modifikon kufizimet e përcaktuara për shefin e paraburgimit, i cili, në përputhje me nenin 17(3) of the Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet mund të dëgjojë deri në 10% të bisedave që incizohen digjitalisht e që përzgjidhen në mënyrë rastësore.

<sup>125</sup> Për *shembull*, funksion telefonik për shkruarje *tekstesh* (TTY), pajisje telefonike për të shurdhër (TDD), shërbime *voice carry-over* (VCO) dhe *hearing carry-over* (HCO).

është urdhëruar tashmë, kur komunikimet jo të privileguara ndërpriten për këtë arsye, Administratorja njofton menjëherë Trupin Gjykses menjëherë dhe përpilon raportin lidhur me të, të cilin ia dorëzon Trupit Gjykses brenda pesë ditësh.

69. Të akuzuarit në fjalë kanë të drejtën të kërkojnë rishikim gjyqsor të vendimit të Administratores në të cilin kufizohen komunikimet e tyre me palë të treta brenda shtatë ditësh, pas marrjes së njoftimit për refuzim nga Administratorja. Kërkesa për rishikim gjyqsor të vendimit bëhet në përputhje me nenin 9(2)-(6) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative lidhur me Ankesa (KSC-BD-11-Rev1).

#### **9. Regjistri dhe incizimet e vizitave dhe komunikimeve me video dhe audio**

70. Sikurse parashihet në rregullat e brendshme,<sup>126</sup> shefi i paraburgimit mban një regjistër të të gjitha thirrjeve me audio ose video dalëse ose hyrëse, përfshirë emrin e të paraburgosurit, emrin e vizitorit, numrin telefonik, datën, orën dhe kohëzgjatjen e thirrjes, dhe çdo informacion tjetër që shefi i paraburgimit e gjykon të rëndësishëm.<sup>127</sup> Administratorja kontrollon këtë regjistër çdo javë për të vërtetuar, kur është e nevojshme pas konsultimit me ZPS-në, nëse duhet të kryhet kontrollimi aktiv i ndonjërit prej incizimeve.

71. Kjo masë vlen dhe për komunikimet e z. Krasniqi. Sikurse u theksua më lart, kjo ka për qëllim të sigurojëse masat lidhur me tre të akuzuarit të mund të zbatohen në mënyrë efektive nga Administratorja nën mbikëqyrjen e Trupit Gjykses. Trupi Gjykses bindet se kjo masë përputhet me mbrojtjen efektive të të drejtave të z. Krasniqi dhe është e domosdoshme dhe proporcionale në rrethanat aktuale.

---

<sup>126</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 16(4).

<sup>127</sup> Udhëzuesi i Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 16(4).



72. ZPS-ja kërkon që incizimet e vizitave dhe komunikimeve dalëse ose hyrëse me tre të akuzuarit, të kryhen deri në fund të procesit gjyqësor.<sup>128</sup> Trupi Gjyqësor konstaton se kjo masë është e domosdoshme dhe proporcionale në rrethanat aktuale.<sup>129</sup>

#### F. LETËRKËMBIMI

73. Bazuar në informacionin që ka aktualisht, Trupi Gjyqësor nuk sheh arsyetime për ndalim ose kufizim të kësaj forme komunikimi për tre të akuzuarit. Në përputhje me rregullat përkatëse, ky komunikim është objekt i mbikëqyrjes pasive. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor urdhëron që Zyra Administrative të kopjojë sistematikisht dhe të ruajë kopje të letërkëmbimit të tre të akuzuarve deri në përfundim të kësaj çështjeje gjyqësore.

74. Administratorja ose shefi i paraburgimit duke vepruar në emër të Administratores, mund të vendosin kufizime të arsyeshme për numrin e letrave që të akuzuarit lejohen të dërgojnë, në raste kur kjo gjykohet e domosdoshme për të siguruar zbatimin efektiv të Vendimit aktual. Në raste kur Administratorja ka tregues të besueshëm se letërkëmbimi mund të përdoret për qëllime në kundërshtim me rregulloren e paraburgimit dhe/ose Vendimin aktual, ajo ka autorizimin të kontrollojë përmbajtjen e letërkëmbimit përkatës. Administratorja njofton menjëherë Trupin Gjyqësor për këtë veprim.

75. Tre të akuzuarve u sillet në vëmendje gjithashtu se letërkëmbimi nuk mund të përdoret për të bërë të ditur informacion konfidencial dhe/ose informacion i cili mund të identifikojë dëshmitarë të mbrojtur për palë të treta të paautorizuara. Letërkëmbimi nuk përmban gjuhë të koduar. Përdorimi i gjuhës së koduar përbën

---

<sup>128</sup> Kërkesa, para. 2(c)(i), (ii).

<sup>129</sup> Trupi Gjyqësor vë në dukje se kjo është zgjatje e periudhës 8-mujore e pasqyruar në nenin 17(2) të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet, i cili gjithashtu autorizon Administratoren konkretisht për zgjatje të periudhës.

arsye që Administratorja të ushtrojë kompetencën e vet diskrecionale për të mos lejuar letërkëmbimin për marrësin e synuar.

76. Përveçse kur ka të bëjë me ndalimin e përgjithshëm të komunikimit të informacionit konfidencial, kjo masë nuk zbatohet për letërkëmbimin që është shënuar qartë se vjen nga ose dërgohet te Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Avokati i Popullit, Administratorja ose një anëtar i personelit që vepron në emër të saj, një gjykatës apo panel i Dhomave të Specializuara ose anëtar i personelit që vepron në emër të tyre, çdo autoritet gjyqësor i pranuar nga Administratorja.<sup>130</sup> As letërkëmbimet me kryembrojtësin ose bashkëmbrojtësin nuk ndikohen nga Vendimi aktual.

#### G. DETYRIMET E RAPORTIMIT TË ZYRËS ADMINISTRATIVE

77. Në përputhje me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin, masat e urdhëruara këtu, duhet të mbahen për aq kohë sa i shërbejnë qëllimit legjitim dhe vazhdojnë të jenë të domosdoshme dhe proporcionale. Trupi Gjykses do të rishikojë kushtet e paraburgimit të përmendura këtu, ose çdo gjashtë muaj *proprio motu* dhe/ose me kërkesë të arsyetuar nga një i akuzuar në varësi të masave.

78. Trupi Gjykses vendos për Administratoren detyrimet në vijim në mënyrë që të jetë i informuar për rrethanat lidhur me këto aspekte. Administratorja i dorëzon Trupit Gjykses raport çdo dy muaj, në të cilin do të përfshihet më së paku informacioni në vijim:

- (a) përqindja e thirrjeve të incizuara të cilat mbikëqyren aktivisht (për çdo të akuzuar);
- (b) çdo incident për të cilin është përfunduar komunikimi jo i privilegjuar;

---

<sup>130</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 19(5), (6).

- (c) çdo refuzim i Administratores për moslejimin e vizitës ose thirrjes jo të privilegjuar;
- (d) numri i miratuar i vizitave personale jo të privilegjuara personale, thirrjeve me audio ose video dalëse ose hyrëse për tre të akuzuarit;
- (e) çdo incident për mosrespektim të Rregullores së Paraburgimit dhe/ose Vendimit të Trupit Gjykses gjatë kontakteve jo të privilegjuara;
- (f) çdo komunikim i dyshimtë i identifikuar gjatë kontrollimit të komunikimeve të incizuara;
- (g) çdo incident, ngjarje ose rrethanë tjetër me rëndësi që siguron se Trupi Gjykses ka mundësi të garantojë integritetin e procesit gjyqësor, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe/ose parandalojë shpërndarjen e informacionit konfidencial;
- (h) informacion lidhur me shpenzimin e burimeve nga Administratorja për kushtet e urdhëruara të paraburgimit dhe përditësime mbi kapacitetin e Administratores për vazhdimin e zbatimit të këtyre kushteve; dhe
- (i) nëse ka rrethana të reja ose të tjera që ndikojnë në efektivitetin dhe/ose domosdoshmërinë e masës ose masave të urdhëruara.

#### H. TË DREJTAT NË FUQI QË MBETEN TË PANDRYSHUARA

79. Trupi Gjykses vë në dukje se Vendimi nuk ndikon në të drejtat e përfaqësuesve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Avokatit të Popullit, Administratores, gjykatësve të Dhomave të Specializuara, ose të anëtarëve të personelit që veprojnë në emër të këtyre organizatave dhe personave.

80. Trupi Gjykses ka refuzuar gjithashtu të miratojë në këtë fazë masa kufizuese në lidhje me vizitat private. Ky është rezultat si i rëndësisë së këtyre vizitave për

të akuzuarit<sup>131</sup> ashtu dhe faktit që deri tani nuk ka asnjë tregues se këto vizita janë shfrytëzuar për sjellje të parregullt. Megjithatë, Trupi Gjykses dëshiron të bëjë të qartë se nuk do të hezitojë të vendosë kufizime shtesë<sup>132</sup> për vizitat private në rast se gjatë vizitave ndonjë palë do të kryejë sjellje të parregullt.

81. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se nuk ka bazë që anëtarëve të ekipeve të Mbrojtjes t'u kufizohet qasja në sistemin e shkëmbimit të mbrojtur elektronik të dhënave ("SEDS").<sup>133</sup> Deri tani nuk ka asnjë tregues se ndonjë anëtar i ekipeve të Mbrojtjes është sjellë në mënyrë të parregullt ose se ka keqpërdorur sistemin SEDS. Gjithashtu, SEDS -ja është mjet përgatitor i dobishëm dhe kufizimet në lidhje me të mund të ngadalësojnë ose pengojnë panevojshëm përgatitjet e Mbrojtjes.

#### I. MASA TË TJERA

82. Sa u përket masave të tjera të kërkuara nga ZPS-ja, të cilat nuk janë trajtuar konkretisht më lart, Trupi Gjykses konstaton se ato nuk përlligjen dhe/ose janë shproporcionale në këtë fazë.<sup>134</sup> ZPS-ja dhe Zyra Administrative vazhdojnë të mbikëqyrin rrethanat gjatë zbatimit të përgjegjësisve përkatëse të tyre. Nëse rrethana të reja përlligjin një ndryshim të masave aktualisht në fuqi, ata informojnë Trupin Gjykses në një mënyrë të përcaktuar nga Ligji dhe Rregullorja.

---

<sup>131</sup> *Shih për shembull* KEDNJ, neni 8.

<sup>132</sup> *Shih* Udhëzuesin e Punës mbi Vizitat dhe Komunikimet, neni 24.

<sup>133</sup> *Shih* Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 50.

<sup>134</sup> *Shih për shembull* Kërkesën, para 50 (që i kërkon Zyrës Administrative të lëshojë rregullisht raporte për palët).

## V. KLASIFIKIMI

83. Trupi Gjykses vë në dukje se Përgjigjet prej secilit të akuzuar dhe Parashtrimet e Zyrës Administrative u dorëzuan konfidencialisht. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Veselit kanë dorëzuar versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse.<sup>135</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit, Mbrojtjen e Krasniqit dhe Zyrën Administrative të parashtrojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse ose të kërkojnë që parashtrimet e tyre paraprake të riklasifikohen si publike jo më vonë se të mërkurën, 6 dhjetor 2023.

## VI. VENDIM

84. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- (a) **ANULON dhe ZËVENDËSON** masat e përkohshme të urdhëruara në Vendimin e Përkohshëm të Trupit Gjykses, që hyn në fuqi sapo të jenë zbatuar të gjitha masat përkatëse në Vendimin aktual.
- (b) **MIRATON PJESËRISHT** Kërkesën e ZPS-së sikurse specifikohet në paragrafët 51-53, 55-60, dhe 62-78 të vendimit aktual;
- (c) **URDHËRON** Administratoren të marrë masa dhe të zbatojë menjëherë modifikimet e kushteve sikurse përcaktohen në paragrafët 51-53, 55-60, dhe 62-78, dhe të njoftojë Trupin Gjykses kur të jetë realizuar kjo.
- (d) **URDHËRON** Administratoren t'i dorëzojë Trupit Gjykses një raport përmbledhës në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 78 të vendimit aktual çdo dy muaj (raporti i parë pritët më 1 shkurt 2024), ose edhe më herët, nëse Administratorja e gjykon të domosdoshme;
- (e) **U KUJTON** të akuzuarve detyrimet e tyre për të mos shpërndarë për palë

---

<sup>135</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimet. 6, 15, 16.

- të treta të paautorizuara ose për të mos nxjerrë për ta asnjë informacion konfidencial dhe/ose informacion që mund të çojë në identifikimin e dëshmitarëve të mbrojtur;
- (f) **RRËZON** pjesën tjetër të Kërkesës së ZPS-së;
- (g) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit, Mbrojtjen e Krasniqit dhe Zyrën Administrative të parashtrojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse ose të kërkojnë që parashtrimet paraprake të tyre të riklasifikohen si publike deri të mërkurën, 6 dhjetor 2023.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

E premte, 1 dhjetor 2023  
Hagë, Holandë.